



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Valmirë Deliu	09.01.2025	16.01.2025	2024/1265

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 24.12.2024, OE “Interlab SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/1265, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me skaner mobil x-ray” me nr. të prokurimit: "201 13300-24-8435-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Dogana e Kosovës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurën e hapur**, lloji i kontratës: **furnizim**, vlera e parashikuar e kontratës: **2,110,000.00 €**.

Shënim: *Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, nuk është nxjerr ndonjë vendim i mëparshëm i OSHP-së.*

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Pretendimet ankimore:

- Lista e kontratave dhe referencave:** Ankuesi pretendon se ka përmbushur kërkesën për kontrata dhe referenca të ngjashme me vlerën e përcaktuar në dosjen e tenderit (DT). Kanë prezantuar dokumentacion që dëshmon përmbushjen e kësaj kërke, përfshirë kontratat e ngjashme për skanera X-Ray dhe dokumente të tjera mbështetëse.
- Arsyetimi për anulim për shkak të buxhetit:** Ankuesi kundërshton anulimin e tenderit për arsye buxhetore, duke theksuar se të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë

brenda buxhetit të planifikuar. Për më tepër, kjo është hera e dytë që tenderi publikohet me të njëjtin buxhet prej 2,110,000 Euro.

Shkeljet ligjore të pretenduara:

- **Neni 1 – Qëllimi**
- **Neni 6 - Ekomiciteti dhe Efikasiteti**
- **Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi**
- **Neni 8 - Planifikimi i Prokurimit**
- **Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve**
- **Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës**

Propozimi i ankuesit:

- Pranimi i ankesës si e bazuar dhe anulimi i vendimit të datës 02.12.2024 për anulimin e tenderit.
- Rivlerësimi i procedurës së prokurimit dhe shpërblimi i ankuesit me kontratë, duke qenë se plotëson të gjitha kërkesat e tenderit.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
a. Vlera minimale prej se paku 1,000.000.00 euro në lidhje me furnizimet e ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë (FPP 33282000-0 projekte të ngjashme qe lidhen me sisteme të ngjashme / Skanera X-Ray), rekomandohen të jenë të shitura në vendet e BE-se;	a. Një listë e kontratave për furnizime të ngjashme të realizuara në 3 vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, ku përfshihen furnizime të ngjashme Skanera X-Ray të bashkangjitur për dëshmi si kopja e certifikatës, raport pranimi apo referencë qe dëshmojnë për funksionimin e tyre.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

DEKLARATË

Komisioni i vlerësimit të tenderit për: “Furnizim me skaner mobil x-ray”, me nr. Pr. 201 13300-24-8435-1-1-1 dhe numër brendshëm 201 13300-24-024-1-1-1, pas vlerësimit të pesë ofertave në raport me kushtet e dosjes së tenderit, vjen në përfundim që ky tender të anulohet për arsye të planifikimit buxhetor për vitet në vijim dhe se të gjitha ofertat janë të papërgjegjshme të kërkesa e dosjes së tenderit, pika 9.1 e FTD. Asnjë nga ofertuesit nuk kanë paraqitur dëshmi se kanë referenca dëshmi në tri vitet e fundit për furnizim me skaner mobil që lidhen me sisteme të ngjashme sipas kërkesave të specifikimit teknik.

Kërkesat mbi mundësitë teknike

dhe/ose profesionale 9.1 a. Vlera minimale prej se paku 1,000.000.00 euro në lidhje me furnizimet e ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë (FPP 33282000-0 projekte të ngjashme që lidhen me sisteme të ngjashme / Skanera X-Ray), rekomandohen të jenë të shitura në vendet e BE-se.

9.2

a. Një listë e kontratave për furnizime të ngjashme të realizuara në 3 vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, ku përfshihen furnizime të ngjashme Skanera X-Ray të bashkangjitur për dëshmi si kopja e certifikatës, raport pranimi apo referencë që dëshmojnë për funksionimin e tyre.

Dhe duke qenë se ky projekt nuk mund të realizohet këtë vit duke pasur parasysh afatin e gjatë të liferimit sipas ofertave të OE, i cili kalon në vitin 2025 dhe DK ka të planifikuar për blerje të skanerëve me pak mjete sesa vlera e ofertave.

Prandaj, bazuar në rregullat e prokurimit publik komisioni i vlerësimit rekomandon anulimin e këtij tenderi për arsyet e cekura më lartë.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Interlab SH.P.K.**

PËRSHKRIMI I ANKESËS

Në ankesën e paraqitur pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), Operatori Ekonomik (OE) **Interlab SH.P.K.** ka pretenduar se është eliminuar në mënyrë të padrejtë nga tenderi për "Furnizim me skaner mobil X-Ray". Ankuesi thekson se Autoriteti Kontraktues (AK) - Dogana e Kosovës, ka shkelur dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), duke mos respektuar barazinë në trajtim, transparencën dhe procedurat e përcaktuara gjatë vlerësimit të ofertave.

Pretendimet përfshijnë eliminimin e padrejtë të ofertës së Interlab SH.P.K., pavarësisht përmbushjes së kërkesave teknike dhe profesionale të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. Gjithashtu, ankuesi kundërshton anulimin e tenderit për arsye buxhetore, duke argumentuar se buxheti ka qenë i planifikuar dhe i disponueshëm për procedurën e tenderimit.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të ankuesit dhe vendimet e AK-së, duke paraqitur konstatimet dhe vlerësimet e tij si më poshtë:

Pretendimi Ankimor 1

Ankuesi pretendon se AK, për këtë procedurë të prokurimit, ka eliminuar ofertën e Interlab SH.P.K. duke pretenduar se nuk është plotësuar kriteri për listën e kontratave dhe referencave të ngjashme, ashtu siç është kërkuar në Fletën e të Dhënave (FDT) në Dosjen e Tenderit (DT). Sipas ankuesit, oferta e tij është e plotë dhe përmbush të gjitha kërkesat, përfshirë kontratat e prezantuara në listën e kontratave dhe referencave të ngjashme me objektin e furnizimit. Ankuesi deklaron se ka paraqitur dokumentacion të plotë sipas kërkesës së AK-së, ku përfshihen kontratat për furnizim me **sisteme të ngjashme/Skanera X-Ray** të vlerës së kërkuar prej 1,000,000.00 €.

Interlab SH.P.K. vlerëson se eliminimi është bërë në mënyrë të padrejtë dhe pa bazë, pasi të gjitha kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit janë përmbushur plotësisht.

Vlerësimi i pretendimit nga eksperti shqyrtues:

Eksperti shqyrtues pas analizës së dokumenteve, konstaton se në kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional në FDT, AK ka kërkuar që *“Tenderuesit duhet të dorëzojnë një listë të kontratave për furnizime të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, të cilat duhet të lidhen me sisteme të ngjashme/Skanera X-Ray (FPP 33282000-0), me një vlerë minimale prej 1,000,000 EUR dhe të realizuara preferueshëm në vendet e BE-së. Gjithashtu, AK ka kërkuar si dëshmi certifikata, raporte pranimi ose referenca që dëshmojnë funksionalitetin e pajisjeve”*.

Ankuesi ka dorëzuar një listë të kontratave dhe dëshmi të tjera që përfshijnë furnizime të pajisjeve X-Ray, përfshirë raporte pranimi, referenca dhe test raporte. Lista e kontratave përfshin:

KRKA d.d. (10.12.2021 - 15.02.2022): Vlera 252,097.00 €.

Cablex-M d.o.o. (22.03.2024 - 26.03.2024): Vlera 164,100.00 €.

Zavod za gradbeništvo (24.04.2024 - 06.05.2024): Vlera 699,000.00 €.

KnaufInsulation d.o.o. (07.04.2023): Vlera 580,000.00 €.

Në dokumentet e tenderit, eksperti shqyrtues **ka vërejtur se AK**, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, në kërkesën e saj të datës 25.10.2024, **ka kërkuar sqarime mbi afatet kohore të përfundimit të kontratave. Në këtë kërkesë, nuk është përmendur asnjëherë nevoja për dëshmi shtesë që lidhen me "mobil X-Ray" ose përputhjen teknike të pajisjeve me specifikimet teknike.**

Në dëshmitë e dorëzuara nga ankuesi, vërehet se të njëjtat kanë përmbushur kërkesat e përcaktuara në FDT për vlerën dhe periudhën kohore. Ankuesi ka dorëzuar një listë të kontratave dhe dokumentacion shtesë që përfshin raporte pranimi, referenca dhe test raporte, të cilat dëshmojnë përmbushjen e kriterëve. Megjithatë, termi "mobil X-Ray" nuk është përmendur si kriter i qartë në asnjë pjesë të FDT-së apo në kërkesën për sqarim.

Në njoftimin për eliminim dhe në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim, AK ka theksuar se **ankuesi nuk ka dorëzuar referenca që dëshmojnë furnizime me "mobil X-Ray"**, të cilat lidhen me **sisteme të ngjashme/Skanera X-Ray** sipas specifikimeve teknike. Ky arsyetim për eliminim tregon një ndryshim në fokusin e AK-së, nga kërkesa fillestare për sqarim mbi afatet kohore, në eliminim për mungesën e referencave për "mobil X-Ray".

Eksperti konstaton se ky ndryshim në arsyetim tregon mungesë koherence dhe transparence në

procesin e vlerësimit. Ankuesi ka plotësuar kërkesat fillestare të FDT-së dhe ka ofruar dokumentacionin e kërkuar, i cili përfshin kontrata dhe referenca për **sisteme të ngjashme/Skanera X-Ray**, siç janë përshkruar në dokumentet e tenderit. Përdorimi i termit “mobil X-Ray” si kriter për eliminim, pa një përkufizim të qartë në FDT dhe pa e adresuar atë në kërkesën për sqarim, krijon pasiguri dhe cenon parimin e barazisë në procesin e prokurimit. Eksperti rekomandon që AK të qartësojë këtë mospërputhje në bazë të nenit 7 dhe nenit 59 të LPP-së dhe të rivlerësojë ofertën e ankuesit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në FDT.

Pretendimi Ankimor 2

Ankuesi pretendon se një nga arsyet e dhëna nga AK për anulimin e tenderit është mungesa e fondeve të mjaftueshme (arsye buxhetore). Interlab SH.P.K. argumenton se ky justifikim është i pabazuar, pasi buxheti për këtë procedurë të prokurimit ka qenë i planifikuar dhe i njëjtë edhe në publikimin e mëparshëm të tenderit. Në të dy rastet e shpalljes së procedurës, AK ka përcaktuar të njëjtën shumë prej **2,110,000.00 €** si buxhet për këtë projekt.

Ankuesi thekson se, sipas **Nenit 8 të LPP-së**, AK është i detyruar të planifikojë buxhetin për çdo procedurë të prokurimit përpara publikimit të saj. Kjo kërkesë ligjore garanton stabilitetin financiar dhe shmangien e vendimeve të panevojshme që mund të dëmtojnë procesin. Prandaj, anulimi i tenderit për arsye të mungesës së fondeve bie në kundërshtim me këto parime dhe e bën vendimin e AK-së të pabazuar.

Për më tepër, Interlab SH.P.K. vëren se të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë në këtë procedurë kanë qenë brenda buxhetit të planifikuar nga AK. Kjo tregon se anulimi i tenderit për arsye buxhetore nuk ka bazë reale dhe ndikon në mënyrë të padrejtë në konkurrencën e drejtë dhe të hapur, duke dëmtuar operatorët ekonomikë që kanë përmbushur kriteret financiare dhe teknike të përcaktuara.

Vlerësimi i pretendimit nga eksperti shqyrtues:

Eksperti shqyrtues, gjatë analizimit të dokumenteve të tenderit, ka gjetur se AK, në njoftimin mbi eliminim, ka potencuar se ky projekt nuk mund të realizohet këtë vit duke pasur parasysh afatin e gjatë të liferimit sipas ofertave të operatorëve ekonomikë (OE), i cili kalon në vitin 2025. Gjithashtu, është deklaruar se Dogana e Kosovës ka planifikuar blerje të skanerëve me më pak mjete sesa vlera e ofertave.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të Interlab SH.P.K. dhe dokumentacionit të tenderit në platformën e-Prokurimi, eksperti shqyrtues konstaton se argumenti i AK-së për mungesë fondesh është i pambështetur. Sipas **Nenit 9 të LPP-së**, një aktivitet prokurimi mund të iniciohet vetëm pasi të jenë siguruar fondet përmes **Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Fondeve (DNPDP)**. Planifikimi dhe publikimi i procedurës nga AK konfirmon paraprakisht disponueshmërinë e fondeve. Anulimi mbi këtë bazë përbën shkelje të Nenit 9 të LPP-së dhe parimit të sigurisë financiare të procesit të prokurimit.

Në **FDT të DT**, AK ka përcaktuar një afat kohor prej **12 muajsh** për fillimin dhe përfundimin e kontratës, duke qenë plotësisht i vetëdijshëm për afatin e zbatimit të projektit edhe nëse ai kalonte në vitin 2025. Ky fakt, së bashku me buxhetin e njëjtë të planifikuar për procedurën e ritenderuar, e bën argumentin për anulim për arsye buxhetore kontradiktor dhe të pabazuar. Ritenderimi i procedurës me të njëjtin buxhet dhe pa ndryshime në afatet kohore apo financiare, tregon mungesë të koherencës në veprimet e AK-së dhe bie ndesh me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (RrPP), e cila kërkon që planifikimi financiar të jetë i qëndrueshëm dhe i përshtatshëm për të shmangur anulimet e panevojshme.

Anulimi i procedurës për arsye të pretenduara të mungesës së fondeve nuk përputhet me faktet dhe dokumentacionin e paraqitur në këtë proces. Ky veprim bie në kundërshtim me parimet e

planifikimit dhe sigurisë financiare që kërkohen nga legjislacioni në fuqi. Eksperti shqyrtues rekomandon që anulimi i procedurës të shpallet i pavlefshëm. Çështja duhet të kthehet në rivlerësim, duke u bazuar në dispozitat e LPP-së dhe duke siguruar drejtësi dhe transparencë për të gjithë pjesëmarrësit në proces.

PËRFUNDIMI

Bazuar në analizën e pretendimeve të ankuesit dhe dokumentacionit të paraqitur, eksperti shqyrtues konstaton se ankesa e Interlab SH.P.K. është e bazuar. Eliminimi për mungesë të referencave për "mobil X-Ray", një kriter i paqartë dhe i papërcaktuar qartë në FDT, përbën shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, të përcaktuar në Nenin 7 të LPP-së. Gjithashtu, AK ka devijuar nga Neni 59 dhe Neni 60 duke eliminuar ofertën e ankuesit pa respektuar kriteret e përcaktuara qartë në FDT dhe duke përdorur kriterë shtesë që nuk ishin të komunikuar paraprakisht.

Për më tepër, anulimi i procedurës për arsye buxhetore të pambështetura, i pasuar nga një ritenderim me kushte të njëjta, shkel parimet e Nenit 6, Nenit 7, dhe Nenit 8 të LPP-së. Ky veprim pasqyron mospërputhje dhe mungesë transparence në procesin e prokurimit, duke dëmtuar drejtësinë dhe besueshmërinë e procedurave të ndjekura nga AK.

Bazuar në analizën dhe pretendimet e ankuesit, eksperti vlerëson se ankesa e Interlab SH.P.K.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Interlab SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me skaner mobil x-ray**” me numër të prokurimit: “**201 13300-24-8435-1-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Dogana e Kosovës**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Dogana e Kosovës**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Interlab SH.P.K.**



Valmirë Deliu